



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Planuar / Dorezuar Primitjen/Prodato Received/Delivery	05.05.2021	viti god year	2021
Organ /Njesia Organ /Jednica Org./Unit	Nr Prot Bj Prot Prot No	Shkujt e Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SHKËMBIM	2209/2021		117



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.239/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës–Kolegji për shqyrtimin e ankesave në përbërje: Malsore Gashi-Bajraktari - kryetar, Eshref Shabani dhe Jeton Koca-anëtarë dhe Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, bazuar në Aktgjykimin A.nr.2420/19 të datës 23.03.2021 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, te pranuar me date 01.04.2021, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.449/2019 të datës 08.08.2019 të parashtruar nga ankuesja kundër Vendimit me Nr. KZKA-8/2019 të datës 08.07.2019 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, në çështjen juridike “kontestim konkursi”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 05.05.2021, mori këtë:

V E N D I M

- I. APROVOHET si e bazuar ankesa me numër A.nr.449/2019 e datës 08.08.2019 e parashtruar nga ankuesja**
- II. SHFUQIZOHET** Vendimi me Nr. KZKA-8/2019 i datës 08.07.2019 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe **Anullohet** procedura e rekrutimit e datës 31.05.2019 e shpallur nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor për pozitën “Udhëheqës i Autoritetit Rajonal të Pellgjeve Lumore”, si dhe të gjitha vendimet që rrjedhin nga kjo procedurë
- III. OBLIGOHET** Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, që të bëjë zbatimin e këtij vendimi brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditë nga dita e pranimit të këtij vendimi.
- IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës** duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, duke u bazuar në Autorizimin e Departamentit të Administrimit të Shërbimit Civil/Ministrisë së Administratës Publike të datës 28.05.2019, më datë 31.05.2019 ka shpall konkursin e brendshëm për pozitën “Udhëheqës i Autoritetit Rajonal të Pellgjeve Lumore”, në të cilin konkurs ka aplikuar edhe ankuesja e cila nga Komisioni Përzgjedhës i Shërbimit Civil në bazë të listës së shkurtër të datës 14.06.2019 nuk është përfshirë në listën e shkurtër.

Më datë 17.06.2019 znj. [emri] përmes emailit zyrtar e ka njoftuar ankuesen se: *“Ju njoftojë që nuk jeni selektuar për pozitën Udhëheqës/e i/e Autoritetit Rajonal të pellgjeve Lumore (Kodi AI/030) me Nr., Ref. MMPH-9/2019, dhe nuk mund të vazhdoni fazat e tjera të konkurrimit për arsye që aplikacioni juaj është i pa kompletuar, kërkuar në bazë të kriterëve të konkursit, do të thotë nuk janë dy vlerësimet e njëpasnjëshme të kërkuara në bazë të rregullores për Avancimin në Karrierë të Nëpunësve Civil Nr. 21/2012, Neni 10 e cila thotë se: Koha minimale për avancim nga një gradë më e ultë në një gradë më të lartë ose nga një kategori më e ultë në kategorinë funksionale të të lartë, është 3 vite kur performanca e nëpunësit civil është vlerësuar mirë dhe shumë mirë, ndërsa 2 vite kur performanca e tij/saj është vlerësuar shkëlqyeshëm”.*

Ankuesja kundër këtij njoftimi me datë 18.06.2019 brenda afatit ligjor ka parashtruar ankesë me Nr. Prot:3811/19 në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.

Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, më datë 08.07.2019 ka nxjerr Vendimin me nr. KZKA-8/2019 me të cilin e ka refuzuar si të pabazuar ankesën e ankueses.

Ankuesja kundër Vendimit me Nr. KZKA-8/2019 të datës 08.07.2019 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, brenda afatit ligjor me datë 06.08.2019 përmes postës ka parashtruar ankesë për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës e cila ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës është pranuar më datë 08.08.2019 dhe është protokolluar më numër 3470/2019.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës më datë 14.08.2019, ankesën e ankueses e ka proceduar për përgjigje në ankesë tek Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor. Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor më datë 15.08.2019 ka përcjell dokumentacionin e kërkuar.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nga muaji janar i vitit 2019 deri më datë 08.10.2020 ka qenë jo funksional dhe nuk ka vendosur për ankesën e ankuesit, ndërsa më datë 10.09.2019, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ka njoftuar ankuesen për arsyet e mos shqyrtimit të ankesës duke e udhëzuar që mund të ndiqni procedurat e mëtejme dhe se në pajtim me Ligjin për Konfliktin Administrativ mund të filloni procedurën gjyqësore pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë–Departamenti për Çështje Administrative.

Ankuesja ka ndjekur procedurat e tjera duke iniciuar konflikt administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë–Departamenti për Çështje Administrative. Gjykata Themelore në Prishtinë–Departamenti për Çështje Administrative më datë 23.03.2021 ka nxjerr Aktgjykim A.nr.2420/19 me të cilin ka aprovuar kërkesëpadinë e paditëses duke anuluar njoftimin e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës të datës 10.09.2019 dhe duke e detyruar Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës që brenda 30 ditësh të vendos për ankesën e datës 08.08.2019.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka administruar këto prova: Ankesën e datës 08.08.2019 me numër protokoll 3470/2019 e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin më Nr. KZKA-8/2019 të datës 08.07.2019 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor; Konkursin e brendshëm për pozitën “Udhëheqës i Autoritetit Rajonal të Pellgjeve Lumore” i datës 31.05.2019 të shpallur nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor; Referencën e datës 20.02.2014 për ARBOTEK për ankuesen; Referencën e datës 01.05.2012 nga EUKOKOS për ankuesen; Referencën e datës 22.12.2006 nga FAMIS CO për ankuesen; Akt Emërimit të datës 21.11.2016 të ankueses; Ndryshimi dhe Plotësimi i Aktit të Emërimit i datës 11.07.2017; Vendimin me Nr. 145/2017 i datës 11.07.2017; Formularin për vlerësimin e rezultateve në punë datë 20.12.2018 dhe 29.12.2017; E-mailin e datës 15.08.2018 nga [] Procesverbalin e datës 25.06.2019 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor; Ankesën e datës 18.06.2019 të ankueses të parashtruar pranë Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor; Njoftimin e datës 17.06.2019 nga [] për ankuesen; Dëshminë për pranimin e aplikacionit i datës 05.06.2019; Raporti mbi selektimin e kandidatëve i datës 14.06.2019; Formularin Form. MAP-SHCK-05 për përcaktimin e kriterëve për përfshirjen në listën e ngushtë për ankuesen i datës 14.06.2019; Vendimin me Nr. Prot:3693/19 i datës 12.06.2019 për emërimin e Komisionit Përzgjedhës të Shërbimit Civil; Formularin Form. MAP-SHCK-04 për regjistrin e aplikacioneve të pranuar; Kërkesën për punësim të ankueses e datës 05.06.2019; Diplomën me Nr. 615 të datës 14.11.2007; Referencës e datës 31.05.2016 nga ËOEBER; Certifikatën e marrëdhënies së punës e datës 23.04.2008 nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor; Pasqyrën e Llogarisë nga TRUSTI; Autorizimin e Departamentit të Administrimit të Shërbimit Civil/Ministrisë së Administratës Publike të datës 28.05.2019; Kërkesën për fillimin e rekrutimit; Përshkrimin e detyrave të punës për “Udhëheqës i Autoritetit Rajonal të Pellgjeve Lumore” datë 23.05.2019; Vendimin me Nr. 364/2018 të datës 07.12.2018 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Raportin e Kolegjit të Vëzhgimit të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës të datës 07.12.2018 dhe Përgjigjen në ankesë e datës 15.08.2019 me numër protokoll 3605/2019; Njoftimin e Datës 10.09.2019 për ankuesen dhe Aktgjykimin A.nr.2420/19 të datës 23.03.2021 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative; Kërkesën për informata e datës 19.02.2021 për ankuesen dhe njoftimin e datës 22.02.2021 nga ankuesja.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës të dërguara nga ankuesi dhe organi i punësimit, ka konstatuar se ankesa e ankueses [] është e bazuar, **sepse:**

Kolegji për shqyrtim e ankesave, ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankueses, e cila pretendon që: Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor nuk më ka ftuar të deklarohet në seancë lidhur me pretendimet ankimore duke vepruar në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi, po ashtu ka vepruar në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi me rastin e refuzimit të ankesës pasi nuk ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike; Komisioni Përzgjedhës me rastin e mos përfshirjes sime në listë të shkurtër ka vepruar në kundërshtim me dispozitat ligjore të legjislacionit për

shërbimin civil pasi që asnjëherë nuk është zbatuar rregullorja për avancim dhe nuk ka ndodh asnjëherë në rastet e tjera të avancimit në ministri.

Kolegji për shqyrtim e ankesave, lidhur me pretendimin ankimor të ankueses e cila pretendon që Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor ka vepruar në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi pasi që nuk e ka ftuar të deklarohet në seancë lidhur me pretendimet ankimore dhe më rastin e refuzimit të ankesës pasi që nuk ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike, ka konstatuar se pretendimi ankueses është i qëndrueshëm pasi që Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor me rastin e dorëzimit të përgjigjes në ankesë të datës 15.08.2019 ka dorëzuar edhe Procesverbalin e datës 25.06.2019 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave (i nënshkruar nga anëtarët e komisionit dhe sekretaria një zyrtare e lartë e personelit) por nuk ka dorëzuar asnjë dëshmi që ankuesja është ftuar të marr pjesë në seancë të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave e cila dëshmi i është kërkuar në kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 13.08.2019, mbi bazë të procesverbalit të datës 25.06.2019, andaj konstatohet që ankuesja nuk është ftuar në seancë të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave, kështu që në rastin konkret është vepruar në kundërshtim me nenin 6 paragrafin 1 dhe nenin 7 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Rregullores Nr. 05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe Ankesave, ku përcaktohet se: **neni 6 paragrafi 1. "Kur ankesat pranohen në Komision në pajtim me nenin 5 të kësaj Rregulloreje, Komisioni fillimisht angazhohet që të zgjidhin kontestin duke i ftuar palët, ankuesin dhe palën ndaj të cilës është bërë ankesë..."** dhe neni 7 paragrafi 1 nën paragrafi 1.7. **"Njësi e Personelit shërben si sekretari për Komisionin dhe ka këto përgjegjësi: njofton anëtarët e komisionit dhe palët për kohën dhe vendin e mbajtjes së seancës"**.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, lidhur me pretendimin ankimor të ankueses e cila pretendon që Komisioni Përzgjedhës me rastin e mos përfshirjes sime në listë të shkurtër ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e legjislacionit për shërbimin civil sepse kjo nuk ka ndodh në rastet e tjera, ka konstatuar që në bazë të e-mailit të datës 17.06.2019 ankuesja është njoftuar se nuk është përfshirë në listë të shkurtër për këto arsye: **"Ju njoftojë që nuk jeni selektuar për pozitën Udhëheqës/e i/e Autoritetit Rajonal të pellgjeve Lumore (Kodi AI/030) me Nr., Ref. MMPH-9/2019, dhe nuk mund të vazhdoni fazat e tjera të konkurrimit për arsye që aplikacioni juaj është i pa kompletuar, kërkuar në bazë të kriterëve të konkursit, do të thotë nuk janë dy vlerësimet e njëpasnjëshme të kërkuara në bazë të rregullores për Avancimin në Karrierë të Nëpunësve Civil Nr. 21/2012, Neni 10 e cila thotë se: Koha minimale për avancim nga një gradë më e ultë në një gradë më të lartë ose nga një kategori më e ultë në kategorinë funksionale më të lartë, është 3 vite kur performanca e nëpunësit civil është vlerësuar mirë dhe shumë mirë, ndërsa 2 vite kur performanca e tij/saj është vlerësuar shkëlqyeshëm"**.

Lidhur me pretendimin ankimor të ankueses se në konkursin e publikuar por edhe në aktin e emërimit të nëpunësve civil nuk evidentohet kategoria funksionale por as grada e vendit të punës, por është përcaktuar vetëm koeficienti, Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ka konstatuar se ky pretendim ankimor është i bazuar, pasi që në asnjë prej dokumenteve të konkursit apo aktit të emërimit, Ministria nuk e ka klasifikuar kategorinë funksionale apo gradën e vendit të punës për pozitën e shpallur, por në konkurs e ka përcaktuar vetëm koeficientin 10 për këtë pozitë.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, po ashtu ka shqyrtuar pretendimin ankimor të ankueses që rregullorja për avancim është e pazbatueshme, duke theksuar që Ministria nuk e ka zbatuar nenin 4 paragrafin 1 të Rregullores nr. 21/2012 për avancimin në karrierë të nëpunësve civilë, ku është përcaktuar se: **"Kërkesa për iniciimin e procedurës për avancimin në karrierë bëhet nga udhëheqësi i njësisë dhe dërgohet për aprovim te udhëheqësi më i lartë administrativ i institucionit"**.

Në bazë të autorizimit të lëshuar nga Departamenti i Administrimit të Shërbimit Civil/Ministrisë së Administratës Publike të datës 28.05.2019, Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka konstatuar se pretendimi ankimor është i bazuar pasi që Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, nuk e ka zbatuar obligimin ligjor sipas nenit 4 paragrafit 1 të Rregullores nr. 21/2012 për avancimin në karrierë të nëpunësve civilë, por që duke u bazuar në Autorizimin e DASHC-së me datë 31.05.2019 e ka shpall konkursin e brendshëm për pozitën “Udhëheqës i Autoritetit Rajonal të Pellgjeve Lumore”, përderisa rregullorja për avancim ka përcaktuar se procedura për avancim miratohet nga udhëheqësi më i lartë administrativ i institucionit.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, po ashtu ka shqyrtuar pretendimin ankimor të ankueses që Ministria nuk e ka zbatuar rregulloren, sepse rregullorja është e pazbatueshme pa qene ne fuqi sistemi i klasifikimit ne kategori dhe ne grada, dhe që konkursi është hapur për të gjithë nëpunësit e MMPH-se.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka konstatuar se ky pretendim ankimor është i bazuar pasi që me dispozitat e Rregullores nr. 21/2012 për avancimin në karrierë të nëpunësve civilë, me nenin 5 paragrafin 2 është përcaktuar se: „Shpallja e avancimit fillimisht bëhet brenda njësisë së institucionit” kurse me paragrafin 3 është përcaktuar se „Nëse në pozitën e lirë aplikojnë më pak se tre kandidatë të cilët i plotësojnë kriteret sipas kësaj Rregulloreje, njësia e personelit shpall konkurs në nivel institucioni”.

Duke marr parasysh këtë dispozitë ligjore konstatohet që organi i punësimit nuk i ka zbatuar dispozitat ligjore për shpalljen dhe organizimin e procedurës së avancimit sipas rregullores 21/2012 për avancimin në karrierë të nëpunësve civilë.

Po ashtu Kolegji për shqyrtimin e ankesave e ka pranuar si të qëndrueshëm pretendimin ankimor të ankueses që organi i punësimit ka qenë i obliguar që bazë të nenit 5 paragrafit 5 të Rregullores nr. 21/2012 për avancimin në karrierë të nëpunësve civilë, në shpalljen e avancimit të përcaktoj si në vijim: „Shpallja duhet të përmbaj: Emrin e institucionit, emrin e njësisë organizative, titullin e vendit të punës, kategorinë funksionale dhe gradën e pozitës, vendndodhjen e pozitës, përmbledhjen e shkurtër të përshkrimit të punës, kriteret e vendit të punës, vendin ku mund të merren kërkesat për aplikim”.

Në bazë të konkursit të publikuar me datë 31.05.2019 nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor për pozitën “Udhëheqës i Autoritetit Rajonal të Pellgjeve Lumore”, konstatohet që organi i punësimit nuk ka përcaktuar në konkurs kategorinë funksionale dhe gradën e pozitës, por e ka publikuar vetëm koeficientin 10.

Në bazë të gjitha këtyre konstatimeve, si dhe duke marr parasysh të gjitha vendimet e nxjerra nga Këshilli në procedurën e ankesave, në procedurën e vëzhgimit të rekrutimit/avancimit të pozitave drejtuese si dhe në procedurën e monitorimit të zbatimit të ligjit, Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka konstatuar dhe konfirmon që në momentin e zhvillimit të procedurës së avancimit sipas konkursit të publikuar me datë 31.05.2019 nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor për pozitën “Udhëheqës i Autoritetit Rajonal të Pellgjeve Lumore”, nuk janë zbatuar dispozitat e Rregullores Nr. 21/2012 për Avancimin në Karrierë të Nëpunësve Civil, pasi që nuk ka qenë i përfunduar procesi i klasifikimit të vendeve të punës në shërbimin civil gjegjësisht përcaktimit të kategorisë funksionale, të gradës dhe të hapit të secilës pozitë të shërbimit civil.

Duke marr parasysh këto fakte të konfirmuara në të gjitha vendimet e Këshillit lidhur me moszbatimin e kriterëve të rregullores për avancim, Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka konstatuar se Komisioni Përzgjedhës i organit të punësimit ka vepruar në kundërshtim me ligjin me rastin e përjashtimit të ankueses

nga procesi i rekrutimit me arsyetimin e zbatimit të dispozitave të rregullores për avancim, duke kërkuar që të zbatohet vetëm dispozitat që kanë të bëjnë me vlerësimin e punës, e duke dështuar të zbatohet të gjitha dispozitat tjera që kanë të bëjnë me miratimin e shpalljes së avancimit nga Sekretari i Ministrisë, shpalljen brenda njësisë, pastaj shpalljen brenda ministrisë, përcaktimin e kategorisë funksionale dhe të gradës për pozitën e shpallur e shumë dispozita tjera.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ka konstatuar se Komisioni i Ankesave i organit të punësimit i ka tejkaluar të gjitha këto shkelje, dhe me Vendimin nr. KZKA-8/2019 të datës 08.07.2019 ka vendosur të refuzoj si të pabazuar ankesën e ankueses të datës 18.06.2019.

Po ashtu Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ka konstatuar se edhe Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor me rastin e nxjerrjes së Vendimit Nr. KZKA-8/2019 të datës 08.07.2019 gabimisht i'u është referuar dispozitave të nenit 10 të Rregullores Nr. 21/2012 për Avancimin në Karrierë të Nëpunësve Civil, rrjedhimisht Kolegji për shqyrtimin e ankesave, konstaton se arsyetimi i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor është i paqartë dhe kundërthënës dhe si i tillë është në kundërshtim me dispozitat e nenit 48 paragrafit 2 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili përcakton se: *"Një arsyetim që është dukshëm i pamjaftueshëm, i paqartë, kundërthënës apo i pakuptueshëm, është i barabartë me mungesën e tij"*, kështu që pretendimet e ankueses janë të bazuara.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, konstaton se në bazë të dispozitave të nenit 28 të Rregullores Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil janë përcaktuar në mënyrë të saktë kriteret për përfshirje në listën e shkurtër dhe në bazë të këtyre kriterëve dhe dëshmimeve të dërguara nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor me përgjigjen në ankesë, konstatohet se ankuesja i ka plotësuar kushtet e konkursit duke poseduar dëshmitë e përgatitjes profesionale dhe atë të përvojës së punës profesionale dhe menaxheriale, andaj me rastin e përjashtimit të ankueses nga procedura e rekrutimit, kemi të bëjmë me shkelje të dispozitave të nenit 11 paragrafit 1 të Ligjit nr.03/L-149 për Shërbimin Civil ku është përcaktuar se *„Pranimi në Shërbimin Civil të Kosovës bëhet në pajtim me parimet e meritës, aftësisë profesionale, paanshmërisë, mundësive të barabarta, mosdiskriminimit dhe përfaqësimit të barabartë, në bazë të konkursit publik dhe pas verifikimit të zotësisë së veprimt të kandidatëve"*.

Duke marr parasysh të gjitha faktet e lartëcekura, si dhe shkeljet e konfirmuara, Kolegji për shqyrtimin e ankesave, konstaton se Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, është i obliguar që të bëjë zbatimin e këtij vendimi brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, duke anuluar procedurën e rekrutimit respektivisht të avancimit të datës 31.05.2019 të shpallur nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor për pozitën "Udhëheqës i Autoritetit Rajonal të Pellgjeve Lumore" si dhe të gjitha vendimet që rrjedhin nga kjo procedurë.

Në rast të moszbatimit të vendimit të Këshillit nga personi përgjegjës i përcaktuar në dispozitiv të këtij vendimi, Kryetari i Këshillit ndërmerr veprimet në pajtim me nenin 21, 23 dhe 24 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke aplikuar edhe ndalimin e 50 % të pages mujore për personin përgjegjës, deri në zbatimin e vendimit të Këshillit.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 në paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi. Anëtarët e Kolegjit i cili ka dhënë mendim mospajtues me këtë vendim, duhet të jap me shkrim mendimin mospajtues dhe i njëjti duhet t'i bashkëngjitet dosjes së lëndës.



Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.239/2021

Avdy BEKTESHI

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

Malsore GASHI-BAJRAKTARI

Kryetar i Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- Ankueses
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor;
- Udhëheqësit të Personelit në Ministrinë e Mjedisit, dhe Planifikimit Hapësinor; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së